



KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin e
përfunduar më 31 Dhjetor 2020**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë	7
Shënimet për pasqyrat financiare	8 - 41
Aneks Pasqyrat Plotësuese	

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin dhe aksionarët e ELSIG SH.A.

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të ELSIG SH.A. ("Kompania"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, dhe shënimet tjera shpjeguese për pasqyrat financiare duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin mbi bazë për opinion të kualifikuar më poshtë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë së sigurimit më 31 Dhjetor 2020, dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në fonde dhe rrjedhën e parasë për periudhën që ka përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinion të Kualifikuar

- i. Siç është shpalosur në shënimin 11 të pasqyrave financiare, balanca e të arkëtueshmeve nga regreset të kompanisë më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 ishte në shumë prej 1,096 mijë Euro, përkatësisht 1,071 mijë Euro. Njohja e këtyre pasurive bazohet në paditë dhe pretendimet e iniciuara nga kompania kundrejt kompanive të tjera të sigurimeve dhe individëve për dëmet e paguara nga kompania dhe që konsiderohen të rikuperueshme nga kompanitë dhe individët e tjerë. Megjithatë, bazuar në informatat dhe provat e marra nga kompania, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse mbledhja e këtyre të arkëtueshmeve është pothuajse e sigurt dhe nën kontrollin e kompanisë, kështu që ne nuk arritëm të marrim siguri në lidhje me vlefshmërinë dhe rikuperueshmërinë e këtyre pasurive më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019. Çdo rregullim që mund të jetë gjetur i nevojshëm në lidhje me më sipër, do të kishte një efekt të rëndësishëm në pozitën financiare të kompanisë më 31 Dhjetor 2020, fitimi për vitin dhe shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare.

Përpos çështjeve të cekura në paragrafët mbi bazën për opinion të kualifikuar ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të ELSIG SH.A. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar për ato pasqyra më 9 Qershor 2020. Opinioni ishte kualifikuar në lidhje me balancën e të arkëtueshmeve nga regreset si dhe metodën e përllogaritjes për dëmet e ndodhura por jo të raportuara IBNR.

Çështjet kryesore të auditimit

Me përjashtim të çështjeve të përshkruara në seksionin për Bazën e Opinioneve të Kualifikuara ne kemi përcaktuar që nuk ka çështje të tjera kryesore të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Raportimi në informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat e tjera. Informatat tjera përfshijnë një shtojcë e cila përmban “Margjinën e Solvencës”, “Llogaritjen e Kapitalit” dhe “Mjaftueshmërinë e investimeve së aseteve në mbulim të provizioneve teknike”

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon të dhënat e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë të konkluzioneve të sigurimit.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera dhe, duke vepruar kështu, të shqyrtojmë nëse informatat e tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të fituara në auditim, ose përndryshe duket se përmbajnë gabime materiale.

Nëse, bazuar në punën që kemi bërë në informacionet e tjera të fituara para datës së këtij raporti të auditorit, ne konkludojmë se ka një gabim material të këtij informacioni tjetër, ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç është përshkruar në bazën e opinionit të kualifikuar më lart, ne nuk ishim në gjendje të siguronim dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për vlerën kontabël të arkëtueshmet nga regreset më 31 Dhjetor 2020. Prandaj nuk mund të konkludojmë nëse informatat tjera përmbajnë gabime materiale si rezultat i këtyre çështjeve.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës (rregullat e BQK-së), dhe për kontrollin e brendshëm të cilin menaxhmenti e përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së Kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Personat të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë, në mes tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu u sigurojmë atyre që janë të ngarkuar për qeverisjen me një deklaratë se ne kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe komunikojmë me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që kishin më shumë rëndësi në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe prandaj janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit.

Ne konfirmojmë se:

Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-auditimi të përmendura në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 dhe kemi qenë të pavarur nga Kompania në kryerjen e auditimit.

BDO Kosova L.L.C.
Amir Dërmala
Partner i angazhimit
27 Prill 2021
Rr. Ukshin Hoti, Ob. C4/3, Hy. A, Kati II,
Prishtinë, Kosovë

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2020

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR'000)	Më 31 Dhjetor 2019 (në EUR'000)
PASURITË			
Pasuritë Qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	602	377
Depozitat me afat	8	9,535	9,071
Investimet në instrumentet financiare	9	4,514	2,828
Pjesa e risiguruesve të detyrimeve të sigurimit		171	768
Kostot e përvetësuara të shtyra	10	595	957
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet	11	1,738	1,252
Pasuri të tjera	12	2,119	2,144
Gjithsej pasuritë qarkulluese		19,274	17,397
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiante dhe pajisje	13	219	235
Pasuritë e paprekshme	14	6	6
E drejta e përdorimit të asetit	15	185	369
Gjithsej pasurit jo-qarkulluese		410	610
GJITHSEJ PASURITË		19,684	18,007
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar		4,333	4,333
Fitimi i akumuluar		1,660	1,462
Gjithsej ekuiteti		5,993	5,795
DETYRIMET			
Detyrimet bruto të dëmeve	16	6,915	5,648
Provizioni për primet e pafituara	17	5,602	5,197
Detyrimet nga sigurimi	18	91	256
Detyrimet tjera	19	898	742
Detyrimet e qirasë	15	185	369
Gjithsej detyrimet		13,691	12,212
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		19,684	18,007

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 27 Prill 2021.


Rexhep Idrizaj
Drejtor Gjeneral




Valdete Cikaqi
Drejtoreshë Financiare

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
Pasqyra e të Hyrave Gjithëpërfshirëse
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020

	Shënim	Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020 (në EUR'000)	Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2019 (në EUR'000)
Primet e shkruara bruto	21	9,430	10,074
Minus: Tatimi në prime	25	(94)	(297)
Minus: Primet e lëshuara për ri-siguruesit		(318)	(627)
Neto primet e shkruara		9,018	9,150
Ndryshimi neto në provizionin e primeve të pafituara	16	(405)	(1,060)
Pjesa e risiguruesve në ndryshimin neto të rezervave për primet e pafituara		(600)	77
Primet neto të fituara		8,013	8,167
Komisioni nga risiguruesi		(18)	(64)
Të ardhurat nga interesi		387	285
Shpenzimet e interesit nga qiratë		(14)	(23)
Të ardhurat tjera	22	231	567
Gjithsej të hyrat		8,599	8,932
Dëmet e ndodhura	15	(4,538)	(4,438)
Pjesa e shpenzimeve për BKS-në		(223)	(223)
Nënshkrimi dhe kostot e blerjes së policave		(362)	152
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	13,14	(86)	(87)
Amortizimi i të së drejtës së përdorimit të asetit	15	(184)	(184)
Shpenzimet tjera operative	24	(3,008)	(3,881)
Gjithsej shpenzimet		(8,401)	(8,662)
Fitimi/(Humbja) për vitin		198	270
Të hyra të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		198	270

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020

	Kapitali aksionar (në EUR'000)	Fitimet e mbajtura (në EUR'000)	Gjithsej (në EUR'000)
Bilanci më 1 Janar 2019	4,333	1,192	5,525
Fitimi për vitin		270	270
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2019	4,333	1,462	5,795
Bilanci më 1 Janar 2020	4,333	1,462	5,795
Fitimi për vitin	-	198	198
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2020	4,333	1,660	5,993

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave
financiare.

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020

	Shënim	Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020 (në EUR'000)	Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2019 (në EUR'000)
Fitimi/(Humbja) neto për vitin		198	270
Korrigjuar për:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14	86	184
Amortizimi i të drejtës së përdorimit të asetit		184	87
Të hyrat nga interesi		(387)	(285)
Shpenzimet e interesit		14	23
Zhvlerësimi i provizioneve		-	170
Humbja operative para ndryshimeve në asete dhe detyrime		95	450
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritje)/Zvogëlim në kostot e përvetësuar të shtyra		362	(152)
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet		(486)	101
Pjesa e risiguruesve të detyrimeve të sigurimit		596	(77)
(Rritje)/Zvogëlim në pasuritë tjera		25	(194)
Detyrimet bruto të dëmeve		1,267	408
Provizion për primet e pafituara		405	1,060
Detyrimet nga sigurimi		(165)	(32)
Detyrimet tjera		(18)	135
Pagesa e interesit		(14)	(23)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		2,067	1,676
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e aseteve fikse		(70)	(104)
Rritja e depozitave me afat		(464)	(1,312)
Investime në letra me vlerë		(1,686)	
Interesi i pranuar		387	252
Paraja e gjeneruar në aktivitetet investuese		(1,833)	(1,164)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Detyrimet e qirasë		(9)	(175)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(9)	(175)
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parasë		225	337
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		377	40
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	7	602	377

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Kompania e Sigurimeve 'ELSIG' është themeluar më 21 Maj 2008, dhe operon nën licencën e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës për të kryer biznesin e sigurimeve të përgjithshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Aktiviteti kryesor i kompanisë është sigurimi i automjeteve motorike ndaj palëve të treta. Kompania kryen biznesin e saj në përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës.

Kompania po ashtu ka lëshuar policat në bazë të klasave të biznesit të sigurimit në vijim:

- Sigurim i pronës
- Të gjitha rreziqet e sigurimit ndërtimorë (CAR)
- Sigurimi i shëndetit gjatë udhëtimit
- Aksidentet personale
- Sigurim gjithëpërfshirës i automjeteve

Selia e regjistruar e Kompanisë gjendet në rrugën Tringë Smajli nr 19, Prishtinë, Republika e Kosovës.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

2.1. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet adoptuar nga 1 Janar 2020

Standardet e reja, amendamentet dhe interpretimet që janë efektive për herë të parë për periudhën prej, më ose pas 1 Janar 2020, por nuk kanë efekt material në Kompani kështu që nuk janë diskutuar në detaje tek notat në raportet e pasqyrave financiare:

SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet e Kontabilitetit, Vlerësimet dhe Gabimet (Amendamenti - Iniciativa për Zbulimin - Përcaktimi i Materialit); dhe

Rishikimet e Kornizës Konceptuale për Raportimin Financiar.

Standarde dhe Interpretime të tjera të reja dhe të ndryshuara, të lëshuara nga BSNK që do të zbatohen për herë të parë në pasqyrat financiare të ardhshme vjetore, nuk pritet të ndikojnë në Pasqyrat Financiare të Kompanisë pasi ato nuk janë relevante për aktivitetet e Kompanisë dhe nuk kërkojnë kontabilitet i cili është në përputhje me politikat aktuale të kontabilitetit të kompanisë.

2.2. Standardet dhe interpretimet e lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe jo të aplikuara më herët nga Kompania

Ekzistojnë një numër standardesh, ndryshime në standarde dhe interpretime të cilat janë nxjerrë nga BSNK që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i zbatojë në fillim.

Ndryshimet e mëposhtme janë efektive për periudhën që fillon më 1 Janar 2022:
Kontrata të vështira - Kostoja e Përbushjes së Kontratës (Ndryshimet në SNK 37);
Prona, impiantet dhe pajisjet: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16);
Përmirësimet vjetore të Standardeve të SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41); dhe
Referencat në Kornizën Konceptuale (Ndryshimet në SNRF 3).

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

2.2. Standardet dhe interpretimet e lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe jo të aplikuara më herët nga Kompania (vazhdim)

Në Janar 2020, IASB lëshoi ndryshime në SNK 1, të cilat sqarojnë kriteret e përdorura për të përcaktuar nëse detyrimet klasifikohen si qarkulluese ose jo-qarkulluese. Këto ndryshime sqarojnë se klasifikimi në detyrime qarkulluese ose jo-qarkulluese bazohet në faktin nëse një njësi ekonomike ka të drejtë në fund të periudhës raportuese të shtyjë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit.

Ndryshimet sqarojnë gjithashtu se 'shlyerja' përfshin transferimin e parave të gatshme, të mirave, shërbimeve ose instrumenteve të kapitalit të vet përveç nëse detyrimi për transferimin e instrumenteve të kapitalit lind nga një tipar konvertimi i klasifikuar si një instrument i kapitalit të vet veçmas nga detyrimi i një instrumenti financiar të përbërë. Ndryshimet fillimisht ishin efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janar 2022. Sidoqoftë, në maj të vitit 2020, data e hyrjes në fuqi u shty për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janar 2023.

Një skemë e Kompanisë aktualisht është duke e vlerësuar ndikimin e këtyre standardeve dhe ndryshimeve të reja të kontabilitetit. Kompania nuk beson se ndryshimet në SNK 1 do të kenë një ndikim të rëndësishëm në klasifikimin e detyrimeve të saj, pasi tipari i konvertimit në instrumentet e saj të borxhit të konvertueshëm klasifikohet si një instrument i kapitalit neto dhe për këtë arsye, nuk ndikon në klasifikimin e borxhit të saj të konvertueshëm si një detyrim jo-qarkullues.

Kompania nuk pret që ndonjë standard tjetër i lëshuar nga BSNK, por jo ende efektiv, të ketë një ndikim material në Pasqyrat Financiare të Kompanisë.

3. POLITIKAT KONTABËL

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës të aplikueshme për kompanitë e sigurimit ("Rregullat e BQK-së").

Politikat e rëndësishme kontabël të përshtatura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk shprehet ndryshe.

3.1 Baza e përgatitjes dhe deklaratë e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazën e matjes të specifikuar nga SNRF për çdo lloj pasurie, detyrimi, të ardhure dhe shpenzimi. Baza e matjes është përshkruar në politikat kontabël me poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare është bërë në përputhje me SNRF që kërkon përdorimin e vlerësimeve kritike kontabël. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, apo fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpalosur në shënimin 4: Gjykimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

Kompania ka zbatuar standardet dhe ndryshimet e mëposhtme për herë të parë për vitin financiar që fillon më 1 Janar 2019.

SNRF 16 Qira

Standardi zëvendëson SNK 17 'Qira' dhe për qiramarrësit eliminon klasifikimin e qirave operative dhe qirave financiare. Me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët, aktivet e përdorimit të së drejtës dhe detyrimet përkatëse të qirasë njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Njohja e shpenzimeve të qirasë operative në linjë të drejtpërdrejtë zëvendësohet me një tarifë zhvlerësimi për aktivet e përdorimit të së drejtës (përfshirë në kostot operative) dhe një shpenzim interesi për detyrimet e njohura të qirasë (përfshirë në kostot e financës). Në periudhat e mëparshme të qirasë, shpenzimet që lidhen me qiranë sipas SNRF 16 do të jenë më të larta kur krahasohen me shpenzimet e qirasë nën SNK 17. Sidoqoftë, rezultatet e EBITDA (Fitimet Para Interesit, Taksave, Zhvlerësimit dhe Amortizimit) përmirësohen pasi shpenzimi operativ është tani zëvendësuar nga shpenzimet e interesit dhe zhvlerësimi në fitim ose humbje. Për klasifikimin brenda pasqyrës së fluksit të parave, pjesa e interesit shpaloset në aktivitetet operative dhe pjesa kryesore e pagesave të qirasë shpaloset veçmas në aktivitetet e financimit. Për kontabilitetin e qiradhënësit, standardi nuk ndryshon në mënyrë thelbësore se si një qiradhënës llogarit me qira. Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, me efektin kumulativ të miratimit të SNRF 16 duke u njohur në kapitalin e tij si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të mbajtura për periudhën aktuale. Periudhat e mëparshme nuk janë riparuar. Shuma e njohur në lidhje me të drejtën e përdorimit të pasurive dhe detyrimin e qirasë, shpaloset në shënimin 13 Pronë, pajisjet dhe e drejta e përdorimit dhe shënimi 19 detyrimet e qirasë.

(a) Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Janar 2019

Kompania nuk ka miratuar ndonjë standard të ri ose ndryshime që kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet e kompanisë ose pozicionin financiar.

Standardet dhe ndryshimet që janë efektive për herë të parë në vitin 2019 (për subjektet me fund të vitit 31 Dhjetor 2019) dhe mund të jenë të zbatueshme për kompaninë janë:

Përmirësimet vjetore të SNRF-ve, cikli 2015-2017 (Amendamentet SNRF 3 dhe SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23).

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare dhe prandaj nuk janë bërë të njohura.

(b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Kompania

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, dhe ndryshime në standarde ekzistuese janë publikuar nga BSNK që ende nuk janë efektive, dhe nuk janë miratuar nga Kompania janë dhënë më poshtë. Informacion që pritet të jenë relevante për pasqyrat financiare të kompanisë janë dhënë më poshtë.

Menaxhimi parashikon që të gjitha prononcimet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Kompanisë për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të prononcimit. Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet as të miratuara e as të listuara më poshtë, nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (vazhdim)

(b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Kompania (vazhdim)

SNRKI 23 'Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat'

SNRKI 23 paraqet udhëzime të reja për të sqaruar mënyrën e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat kur është e paqartë nëse autoriteti tatimor do të pranojë trajtimin tatimor të njësisë ekonomike.

Ndryshime në standardet ekzistuese

- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshime në SNRF 9, Instrumentet Financiarë)
- Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28, Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta)
- Ndryshimi i planit, kufizimi ose shlyerja (Amendimi i SNK 19, Përfitimet e punonjësve).

3.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të kompanisë janë paraqitur në Euro ("EUR"), e cila është edhe monedha funksionale e kompanisë. Nëse nuk theksohet ndryshe, pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare janë matur duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik primar në të cilin Kompania vepron ("monedha funksionale").

Transaksionet dhe balancat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga këto transaksione si dhe nga konvertimi me kursin e fund vitit të pasurive dhe detyrimeve financiare në monedhë të huaj njihen në fitim ose humbje.

3.4 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale e entitetit (valutat e huaja) regjistrohen në normat e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, vlerat monetare të shprehura në valutë të huaj konvertohen në vlerat e valutës me datën e paraqitjes së pasqyrave financiare. Vlerat jo monetare që maten sipas kostos historike në një valutë të huaj nuk konvertohen. Ndryshimet në këmbim njihen si profit apo humbje në periudhën ku ato ndodhin.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të hipotezës së vijimësisë, që supozon se Kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj në vlerat e tyre të njohura dhe të shuajë detyrimet në rrjedhën normale të biznesit në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare. Kompania ka njohur një fitim neto pas tatimit në vlerë 198 mijë Euro për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020, rrjedha e parasë nga aktivitetet operative është pozitive për shumën 602 mijë Euro, fitimet e akumuluarra më 31 Dhjetor 2020 janë në vlerë 1,661 mijë Euro, si rrjedhojë, kapitali neto i kompanisë më 31 Dhjetor 2020 është në vlerë pozitive në shumë 5,993 mijë Euro (2019 5,795 mijë Euro), obligimet qarkulluese nuk tejkalojnë kërkesat qarkulluese për 5,583 mijë Euro (2019:obligimet qarkulluese tejkalojnë kërkesat qarkulluese për 5,185 mijë Euro). Kompania është në përputhje me kapitalin minimal të kërkuar nga rregullatori për vitin 2020.

3.6 Klasifikimi i produktit

Kontrata sigurimi janë ato kontrata nëpërmjet të cilave kompania (siguruesi) ka pranuar një rrezik të rëndësishëm sigurimi nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë police-mbajtësin apo përfitues të tjerë nëse një ngjarje e ardhme e pasigurt (ngjarja e siguruar) ndikon negativisht police-mbajtësin apo përfitues të tjerë. Si një rregull i përgjithshëm, kompania përcakton nëse ajo ka rrezik të rëndësishëm sigurimi, duke krahasuar përfitimet e paguara me përfitime të pagueshme nëse ngjarja e siguruar ka ndodhur. Kontratat e sigurimit kanë mundësi të transferojnë rrezikun financiar.

Kontratat e investimeve janë ato kontrata që transferojnë një rrezik të konsiderueshëm financiar. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm të ardhshëm në një ose më shumë komponentë si: norma specifike e interesit, çmimi i instrumentit financiar, çmimi i mallit, kursi i këmbimit, indeksi i çmimit ose normave, norma e kreditimit apo indeksi të kredisë, ose ndryshimi i variablave të tjerë, siç është në rastin e një variabil jo-financiar që variabil nuk është specifik për një palë të kontratës. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë rrezikun financiar. Pasi një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, ajo mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetës, edhe në qoftë se rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shlyhen ose skadojnë. Kontratat e investimeve mund të rreklasifikohen si kontrata sigurimi pas krijimit, në qoftë se rreziku i sigurimit bëhet i rëndësishëm.

3.7 Njohja e të hyrave

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur veçmas për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbërë nga paparashikuara premium (pafituar), të paparashikuara rreziku (të pa skaduar) dhe humbje të paparashikuara (të mos paguhet në datën e mbylljes së vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (Dispozitat) paraqesin vlerësimet e pagesave të ardhshme për kërkesat e raportuara dhe të pa raportuara. Kompania nuk ka zbritje detyrimet e saj të sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësimet janë reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Njohja e të hyrave (vazhdim)

Të ardhurat

Primet e shkruara bruto janë të regjistruar në bazë akruale në bazë të kontratave të sigurimit dhe politikave të lëshuara gjatë vitit dhe janë kredituar për të fituar në një bazë pro-rata gjatë periudhës së mbulimit përkatës të politikave. Primet e shkruara bruto të pasqyruar biznes me shkrim gjatë vitit, dhe të përjashtojë ndonjë taksat ose detyrimet në bazë të primeve. Primet fitohen nga data e lidhjes së rrezikut, gjatë periudhës së dëmshpërblimit, bazuar në modelin e rreziqeve nënshkruara.

Primet e pafituara

Dispozita për primin e pafituar përfshin përqindjen e primeve bruto shkruara e cila vlerësohet të jetë fituar në vitet financiare të mëposhtme ose të mëvonshme, llogaritet veçmas për çdo kontratë sigurimi duke përdorur metodën e përditshme proporcionale, rregullohen nëse është e nevojshme për të reflektuar ndonjë ndryshim në incidencën e rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Megjithatë të gjitha produktet në fuqi nga Kompania kanë rrezik linear dhe nuk janë bërë asnjë ndryshim për ndryshimin e rrezikut.

Primet e pafituara janë proporcione të primit që lidhen me periudhat pas datës së raportimit. Primi I pafituar kalkulohet në primet e shkruara të cilat deklarohen buto nga komisionet e pagueshme tek ndërmjetësuesit duke përjashtuar taksat dhe detyrimet e vëna mbi primitë. Shpenzimet e shtyra të blerjes shtyhen veçmas si një aset.

Të hyrat nga interesi

Të hyrat nga interesi përllogariten përmes metodës lineare, bazuar në kryegjënë e mbetur dhe normën përkatëse të interesit që është norma e interesit që përdoret për aktualizimin e flukseve të ardhshme monetare përgjatë jetës së pritshme të pasurisë financiare duke përcaktuar kështu vlerën bartëse të pasurisë financiare

3.8 Përfitimet nga dëmet dhe njohja e shpenzimeve

Përfitimet dhe dëmet

Dëmet dhe përfitimet e tjera bruto përbëhen nga pagesat ndaj të sigurvearit për dëmet apo përfitime të tjera, si edhe ndryshimet në vlerësimin bruto të detyrimeve mbi kontratat e sigurimit apo investimit me përjashtim të ndryshimeve bruto në primin e pafituar të cilat janë regjistruar si të ardhura nga primet. Gjithashtu përfshijnë kosto të brendshme dhe të jashtme që lidhen direkt me përpunimin dhe zgjidhjen e kërkesave të dëmeve. Kërkesat e dëmeve janë të regjistruara në bazë të njoftimeve të marra.

Kostot e financimit

Interesi i paguar njihet në fitim ose humbje dhe është llogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Interesi i përllogaritur është përfshirë në vlerën kontabël të detyrimit financiar që mbart interes.

Shpërndarja e dividendëve

Shpërndarja e dividendëve për aksionarët e kompanisë është njohur si një detyrim në pasqyrat financiare në periudhën kur ato janë miratuar nga aksionarët e kompanisë.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Përfitimet nga dëmet dhe njohja e shpenzimeve (vazhdim)

Shpenzimet e përfitimeve për pensionin

Kompania nuk ka krijuar ndonjë rezervë dhe nuk ka ndonjë detyrim për pensionet e punonjësve mbi dhe përtej kontributeve të paguara në planin shtetëror të pensioneve, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

3.9 Tatimet

Tatimi mbi primet është kalkuluar në përputhje me legjislacionin në territorin e Kosovës. Shoqëritë e sigurimit paguajnë një tatim 5% mbi primet bruto. Primet e kthyera dhe rregullimet retrospektive të primeve janë zbritur nga primet bruto për të arritur tek baza e tatueshme. Tatimi mbi primet e shkruara bruto pasqyrohet veçmas si një zbritje nga primet e shkruara bruto.

Tatimi mbi primet përbën një pjesë të kostos së blerjes dhe do të shtyhet në një mënyrë të vazhdueshme me metodën e kalkulimit të rezervës për primin e pafituar. Kompanitë e Sigurimit nuk janë të detyruara të paguajnë tatim fitimi mbi fitimin neto në Kosovë.

Nga data 5 gusht 2019 me ndryshimin e Ligjit për tatim në të ardhura të Korporatave, Kompanitë e sigurimit obligohen që nga data e cekur të ndryshojnë trajtimin e tatimit në të ardhura ndaj taksës 5% në primet bruto kanë kaluar në tatimin në fitim prej 10% në pajtim me legjislacionin tatimor të Kosovës: Ligjit nr. -06/L-105.

Të ardhurat nga interesi të marra nga Kompania është gjithashtu përgjegjës i tatimit në burim në masën 10% (2019: 10 %).

3.10 Detyrimet e kontratave të sigurimit

Detyrimet e kontratave të sigurimit të tipit jo jetë njihen kur kompania lidh një kontratë sigurimi me palët e treta dhe primi është ngarkuar. Këto detyrime njihen si rezerva për dëmet pezull, dhe bazohen në kostot finale të gjithë dëmeve të ndodhura dhe të papaguara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, qoftë të raportuara apo jo. Detyrimi njihet kur kontrata përfundon, kthehet apo anulohet.

Rezerva për primin e pafituar përfshin primin e marrë për rreziqet të cilave nuk i ka përfunduar afati. Përgjithësisht, rezerva pakësohet përgjatë periudhës së kontratës dhe njihet si e ardhur nga primi.

Në çdo datë raportimi bëhet testi i mjaftueshmërisë për detyrimet. Ndryshimet në dëmet e pritshme për dëmet që kanë ndodhur për të cilat nuk janë mbyllur, janë pasqyruar duke rregulluar provizionin për dëmet e pa paguara. Provizionin për rrezikun ekzistues është zmadhuar deri në masën që dëmet e ardhshme në lidhje me kontratat e sigurimit aktual kalojnë primet e ardhshme plus provizionin e primit aktual të pafituar.

Dëmet e ndodhura gjatë aktivitetit normal të biznesit

Dëmet e ndodhura gjatë aktivitetit normal të biznesit kanë të bëjnë me dëmet e paguara ndaj police mbajtësve gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në vlerësim të dëmeve pezull.

Dëmet pezull përfshijnë rezervën e përcaktuar mbi bazën e vlerësimeve të kompanisë të gjithë kostove përfundimtare për të paguar të gjitha dëmet e ndodhura e të papaguara në datën e raportimit, qoftë të raportuara apo jo, si dhe kostot e lidhura për trajtimin e dëmeve, të brendshme apo të jashtme, si dhe një marzhë sigurie.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.10 Detyrimet e kontratave të sigurimit (vazhdim)

Edhe pse menaxhmenti beson që rezerva bruto për dëmet si dhe llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi janë prezantuar drejt dhe mbi bazën e informacionit në dispozicion të tyre, detyrimi përfundimtar mund to ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve të mëpasshme dhe ngjarjeve që mund të rezultojnë në korrigjime të rëndësishme të shumave të prezantuara. Korrigjimet në shumat e rezervave të dëmeve të viteve të kaluara prezantohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën është bërë korrigjimi.

Provizioni përben koston përfundimtare për të shlyer të gjithë dëmet duke përfshirë këtu kostot direkte dhe indirekte që rr edhin nga ngjarjet e ndodhura deri në datën e raportimit financiar. Shpenzimet e dëmeve lidhen me vlerësimet për dëmet e raportuara si dhe rezervat për dëmet e pa raportuara. Metoda e përdorur për të përcaktuar rezervat për dëmet bazohet në rregulloret dhe ligjet por mbështetet gjithashtu dhe nga vlerësimet aktuariale.

Provizioni për Dëmet e Raportuara por jo të Paguara (RBNS) vendoset rast pas rasti. Rezerva llogaritet si shuma e pritshme për të shlyer kërkesën dhe vlerësimet rregullohen pasi informacioni i ri bëhet i disponueshëm.

Më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 rezervat teknike për IBNR janë MPTL përcaktohen duke përdorur shkallën e zinxhirit, ndërsa për linjat e tjera të biznesit ato përcaktohen si përqindje e rezervave të RBNS. Përqindja vlerësohet nga aktuari i Kompanisë bazuar në të dhënat e jashtme dhe gjykimin aktuarial.

Risigurimi

Kompania cedon primet e sigurimit dhe rrezikun që lidhet me to gjatë aktivitetit të saj normal për të limituar humbjet e mundshme përmes diversifikimit të rreziqeve të saj që vijnë nga linjat e bizneseve si MTPL, sigurimi i pronës dhe aksidentet personale. Risigurimi përfshin lloje kontratash si ato fakultative dhe kontratat e tejkalimit të humbjes.

Vetëm ato kontrata që rezultojnë në një transferim të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit dhe atë kohor konsiderohen si kontrata risigurimi. Kontratat e risigurimit nuk e çlirojnë kompaninë nga detyrimet e saj direkte ndaj police-mbajtësve. Detyrimet e risigurimit përfshijnë kontratat e risigurimit të pagueshme nga jashtë dhe njihen si shpenzim bazuar në shumën totale të dakorduar me risiguruesin.

Përfitimet e rimbursueshme nga risigurimi paraqiten bruto në pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e të ardhurave ose humbjeve dhe të hyrave të tjera gjithëpërfshirëse.

Rezervat e parashikuara të risigurimit shpalosen veçmas si pasuri në pasqyrën e pozicionit financiar. Të arkëtueshmet nga risigurimi dhe të arkëtueshmet e tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull bazuar në shumat dhe termat e përcaktuara në kontratën e risigurimit.

Kostot e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim janë përcaktuar si shpenzimet që lindin nga shitja e kontratave të reja të sigurimit dhe përfshijnë kostot e drejtpërdrejta si komisionet e agjentëve apo kostot për prodhimin e dokumentit të sigurimit si dhe një pjesë të shpenzimeve administrative të lidhura me procesimin e propozimeve dhe lëshimin e policës.

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim amortizohen në mënyrë sistematike përgjatë jetëgjatësisë së kontratës dhe testohen për dëmtim në çdo datë raportimi. Çdo shumë e pa rikuperueshme do të shpenzohet. Këto shpenzime çnjinhen kur kontratat përfundojnë apo anulohen.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.10 Detyrimet e kontratave të sigurimit (vazhdim)

a. Testimi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Kompania kryen në çdo datë raportimi testimet për të siguruar mjaftueshmërin e rezervave. Testi kryesor i kryer është Analiza e Raportit të Dëmeve si dhe Analiza "Run-off" e rezervës së dëmeve.

Analiza e Raportit të Dëmeve kryhet çdo vit për secilën nga linjat kryesore të biznesit. Përlllogaritja kryhet veçmas për dëmet si dhe më pas për dëmet duke përfshirë kostot e marrjes në sigurim si dhe kosto të tjera të jashtme të trajtimit të dëmeve. Në kryerjen e kësaj analize, kompania merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve monetare dalëse. Kompania nuk i skonton flukset e vlerësuara monetare dalëse pasi që shumica e dëmeve priten të paguhen brenda një viti.

Gjithashtu, kompania performon në çdo vit Analizën e "Run off" për rezervën e dëmeve për të vlerësuar metodën e vlerësimit të rezervës. Analiza Run-off kryhet mbi RBNS dhe IBNR veçmas si dhe në mënyrë të kombinuar. Nëse kjo analizë tregon probleme madhore atëherë korrigjimet e duhura do të bëhen për metodologjinë e vlerësimit të rezervës.

Nëse gjatë testit identifikohet ndonjë problem, ai do të njihet në mënyrë të menjëhershme në fitim ose humbje duke përcaktuar një rezervë për humbjet nga rreziku i primit të pa skaduar që vjen nga Testi i Mjaftueshmërisë së Detyrimeve.

b. Kostot e trajtimit të dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve kanë të bëjnë me shpenzimet e brendshme dhe të jashtme në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe përlllogaritjen e dëmeve nga ana e personelit të kompanisë si dhe shpenzime të jashtme si tarifatat ligjore dhe shpenzime të tjera.

3.11 Prona dhe pajisjet

Njohja dhe matja

Zërat e pasurive afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga dëmtimi. Kostoja historike përfshinë shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e këtyre elementeve.

Nëse pjesë të ndryshme të pasurive afatgjata materiale kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato njihen si pjesë të veçanta (komponentë kryesore) të pasurive afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar hyrjet nga shitja me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në fitim ose humbje në zërin "Fitime(humbje) të tjera".

Kostot pasuese

Kostoja e pasuese njihet në vlerën e mbetur të zërit përkatës ose si një pasuri e veçuar, vetëm nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë në fjalë do të merren nga kompania dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e një e pjese të zëvendësuar do të çnjihet. Të gjithë kostot e tjera të shërbimeve të përditshme të pasurive afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin që ndodhin.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi përlllogaritet me metodën lineare mbi jetën e dobishme të pasurisë. Ambientet me qira zhvlerësohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme, nëse nuk pritet që të drejtat e pronësisë t'i transferohen kompanisë.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.11 Prona dhe pajisjet (vazhdim)

Zhvlerësimi vjetor i pasurive përgjatë periudhës së jetës së dobishme të pasurive për periudhën aktuale dhe periudhën e mëparshme prezantohet si më poshtë:

Zhvlerësimi (vazhdim)

Kategoria	Vitet
Ndërtesa	50
Kompjuterë dhe pajisje të lidhura me to	3-4
Mobile dhe pajisje	3-8
Automjete	5

Vlera e mbetur e pasurive afatgjata materiale si dhe jeta e dobishme rishikohet, dhe nëse është e nevojshme korigjohet, në çdo datë të raportimit financiar. Pasuritë që janë subjekt amortizimi, rishikohen për rënie në vlerë sa herë që ngjarje apo ndryshime në rrethana tregojnë se vlera e mbetur mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse vlera e mbetur e pasurisë është më e lartë se vlera e rikuperueshme atëherë vlera e mbetur e pasurisë do të pakësohet menjëherë për të barazuar vlerën e rikuperueshme të tij. Vlera e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë të pasurisë minus kostot për shitje dhe vlerës në përdorim. Të ardhurat dhe humbjet përcaktohen duke krahasuar flukset hyrëse me vlerën e mbetur. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

3.12 Pasuritë e paprekshme

Njohja dhe matja

Pasuritë e paprekshme që janë blerë nga kompania, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe dëmtimet e akumuluar, nëse ka të tilla.

Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë me të cilën ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruara nga kompania apo markat, njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi përllogaritet si kosto e pasurisë minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për programet kompjuterike dhe një normë vjetore amortizimi prej 20%.

3.13 Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Prona, impiantet dhe pajisjet, ashtu si edhe pasuritë e paprekshme rishikohen për rënie në vlerë kurdo që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana sinjalizojnë që vlera kontabël e pasurisë mund të mos rikuperohet. Kurdoherë që vlera kontabël e pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme, humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse. Shuma e rikuperueshme është shumën më të lartë e çmimit neto shitës të pasurisë dhe vlerës në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shumën e arritshme nga shitja e një pasurie në një transaksion midis palëve të palidhura, ndërsa vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve të pritshme që priten të vijnë nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga nxjerrja e tij në fund të jetëgjatësisë së dobishme. Shumat e rikuperueshme janë llogaritur për pasuritë individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.14 Instrumentet financiare

Kompania i klasifikon pasuritë financiare në kategoritë e mëposhtme: pasuritë financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, huave dhe llogarive të arkëtueshme, pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim dhe pasuritë financiare në dispozicion për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë siguruar investimet. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe rivlerëson këto në çdo datë raportimi.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Kjo kategori ka dy nën- kategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një pasuri financiare klasifikohet në pasuri financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet kategorisë së fitimit ose humbjes në fillim nëse parimisht blihet me qëllim të shitjes në afat të shkurtër, në qoftë se ajo është pjesë e një portofoli të pasurive financiare për të cilën ka prova të fitimit afatshkurtër, ose nëse përcaktohet kështu nga menaxhmenti. Kompania nuk ka pasuri të klasifikuara në këtë kategori në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe llogaritë të arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara të cilat nuk janë të kuotuar në tregje aktive përveç atyre pasurive që kompania synon t'i shesë brenda një periudhe afatshkurtër ose i ka përcaktuar si pasuri me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionin për dëmtim. Sigurimi dhe të arkëtueshmet e tjera, investimet, si dhe paraja dhe ekuivalentët e saj gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për rënie në vlerë si pjesë e procesit të rishikimit të rënies në vlerë kredive dhe të arkëtueshmeve.

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Investime financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara përveç atyre që përmbushin përkufizimin e kredive dhe të tjera të arkëtueshme dhe për të cilat kompania ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Këto pasuri njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionin për dëmtim, nëse ka të tillë. Një provizion për dëmtimin e instrumenteve të borxhit të mbajtur deri në maturim krijohet nëse ka një evidencë objektive që kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Kompania nuk ka ndonjë pasuri të klasifikuar në këtë kategori në datën e pasqyrave financiare.

Pasuritë në gjendje për t'u shitur

Asetet financiare të gatshme për shitje janë asetet financiare jo-derivative që përcaktohen në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në ndonjë kategori tjetër. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

Njohja fillestare

Blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aseteve financiare njihen në datën e tregtimit - datë në të cilën Kompania zotohet për të blerë apo shitur pasurinë. Pasuritë financiare fillimisht njihen në vlerë reale plus, në rast të pasurive financiare që nuk janë të bartura në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që janë direkt të atribuueshme në përvetësimin e tyre. Pasuritë financiare të bartura në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes fillimisht njihen në vlerën e tyre reale, dhe kostot e transaksioneve regjistrohen si shpenzim në fitim apo humbje. Kompania nuk ka ndonjë pasuri të klasifikuar në këtë kategori në datën e pasqyrave financiare.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.14 Instrumentet financiare (vazhdim)

Matja pasuese

Pasuritë financiare të vlefshme për shitje dhe pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes mbahen me vlerë të drejtë. Kreditë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme dhe pasuritë e tjera të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara që lindin si rezultat i ndryshimeve në vlerën e drejtë të pasurive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në periudhën kur lindin. Fitimet dhe humbjet e parealizuara që vijnë si rezultat i ndryshimeve në vlerën e drejtë të investimeve të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në kapital.

Matja pasuese (vazhdim)

Kur letrat me vlerë të klasifikuara si pasuri financiare për shitje janë shitur ose dëmtuar, rregullimet e akumuluar të vlerës së drejtë përfshihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si fitim ose humbje neto nga pasuritë financiare. Fitimet ose humbjet që rezultojnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë në kategorinë "pasuri financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë paraqitur në të ardhura ose shpenzime në zërin fitime neto nga ndryshimi i vlerës së drejtë për pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, në periudhën në të cilën ato lindin. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në kapital.

Interesi nga pasuritë financiare të vlefshme për shitje llogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihet në të ardhura ose shpenzime. Dividendët nga pasuritë financiare të vlefshme për shitje janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur e drejta e Kompanisë për të marrë pagesa është përcaktuar. Të dy rastet e mësipërm janë përfshirë në zërin e të ardhurave nga investimet. Vlera e drejtë e pasurive të kuotuar është bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Në qoftë se tregu për një pasuri financiare nuk është aktiv, kompania e përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve në kushte tregu, referenca për instrumente të tjera që janë në thelb të njëjta, analiza e skontimit të flukseve monetare, etj.

Çregjistrimi

Kompania çregjistron një pasuri financiare vetëm kur të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parasë nga pasuria skadojnë; ose kur e transferon pasurinë financiare dhe rrjedhimisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasuritë i kalojnë entitetit tjetër.

3.15 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë mjetet monetare në arkë, depozitat në bankë të arkëtueshme sipas kërkesës, investime të tjera afatshkurtra dhe investime likuide me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Paraja dhe ekuivalentët e parasë prezantohen në pasqyrat financiare me koston e amortizuar.

3.16 Depozitat me afat

Depozitat me afat janë prezantuar në pasqyrat financiare në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen sipas maturitetit të mbetur. Depozitat me afat me maturitet nën tre muaj klasifikohen si mjete monetare dhe ekuivalente të tyre ndërsa ato me maturitet mbi tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi për llogaritet mbi bazë të parimit akrual.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.17 Detyrimi i qirasë

Detyrimi i qirasë njihet në datën e fillimit të qirasë. Detyrimi i qirasë fillimisht njihet në vlerën e tanishme të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë, që zbritet duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, atëherë zbatohet norma e konsoliduar rritëse e huazimit. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse minus çdo zbritje të pranuar në qira, pagesat variabile të qirasë që varen nga ndonjë indeks apo normë interesi, shumat që pritet të paguhet për vlerën e mbetur të garantuar, çmimin për ushtrimin e opsionit të blerjes, kur një ushtrim i tillë është mjaft i sigurt se do të ndodhë, dhe çdo gjobë që ndërlidhet me përfundimin e kontratës.

Pagesat e ndryshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose një normë përfshihen në shpenzimin e periudhës në të cilën ato ndodhin.

Detyrimet e qirasë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Vlerat bartëse rivlerësohen nëse ka një ndryshim si në vijim: pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose një normë e përdorur; garanci e mbetur; afati i qirasë; sigurinë e një opsioni blerjeje dhe gjobat e përfundimit të kontratës. Kur një detyrim i qirasë është ri-vlerësuar, bëhet një rregullim në pasurinë koresponduese të së drejtës së përdorimit, ose në fitim apo humbje nëse vlera kontabël e të drejtës së pasurisë është zbritur tërësisht.

Qiradhëniet në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra nën qiranë operative ngarkohen në fitim ose humbje në baza lineare gjatë periudhës së qirasë.

3.18 Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka një të drejtë ligjore të zbatueshme për të kompensuar shumat e njohura dhe ka një qëllim të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë përgjegjësi të njëjtën kohë.

3.19 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar paraqet vlerën nominale të aksioneve që janë lëshuar. Aksionet klasifikohen si kapital neto, kur nuk ka asnjë detyrim për të transferuar mjete monetare ose aktive të tjera.

Rezervat

Rezervat e rivlerësimit janë kontabilizuar në librat e Kompanisë si diferencë midis vlerës kontabël të pasurisë dhe pajisjeve dhe aktiveve jo-materiale dhe vlerës së pasurisë dhe pajisjeve dhe aktiveve jo-materiale të përcaktuara me vlerësim të pavarur.

3.20 Sigurimi dhe të arkëtueshmet tjera

Sigurimet dhe të arkëtueshmet e tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionin për efekt të dëmtimit.

Provizioni për rënien në vlerë të sigurimeve dhe të arkëtueshme tjera njihet kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të arkëtueshmeve. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë ose do të pësojë riorganizim financiar, si dhe mos pagesa ose vonesa në pagesa (më shumë se 30 ditë vonesë) konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare kanë rënë në vlerë.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Shuma e provizionit është diferenca mes vlerës kontabël të pasurisë dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Pasuritë me maturim të shkurtër nuk janë skontuar. Vlera kontabël e pasurisë zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Kur sigurimi dhe të arkëtueshmet e tjera janë të pakthyeshme, ajo shlyhet kundrejt provizionit të saj. Rikuperimet pasuese të shumave të zbritura me pare njihen si të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave.

3.21 Rënia në vlerë e pasurive financiare

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për rënie në vlerë. Evidenca objektive e rënies në vlerë të portofolit e të arkëtueshmeve mund të përfshijë përvojën e kaluar të Kompanisë në mbledhjen e pagesave, një rritje në numrin e pagesave në vonesë në portofolin, si dhe ndryshime të dukshme në kushtet ekonomike nacionale dhe rajonale që lidhen me rënie të të arkëtueshmeve.

Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje, përveç nëse pasuria është regjistruar me shumën e rivlerësuar në të cilin rast është trajtuar si një rënie nga rivlerësimi.

3.22 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare klasifikohen në përputhje me thelbin e marrëveshjes kontraktuale. Detyrimet financiare në kosto të amortizuar përbëhen nga huazimet, detyrimet e tjera, si dhe detyrimet e kontratës të sigurimit.

Detyrimi financiar çregjistrohet kur obligimet e kompanisë shkarkohen, anulohen ose përfundojnë.

Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit. Më pas, huazimet barten me koston e amortizuar; çdo diferencë midis të ardhurave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së riblerjes njihet në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tarifat e paguara për kredinë njihen si kosto të transaksionit të kredisë në masën që është e mundur që një pjesë ose e gjithë shuma do të bie. Në këtë rast, pagesa shtyhet derisa të ndodhë tërheqja. Në masën që nuk ka evidencë që është e mundur që një pjesë ose e gjithë shuma do të bie, tarifa kapitalizohet si parapagim për shërbime të likuiditetit dhe amortizohet përgjatë periudhës së kredisë me të cilën lidhet. Huamarrjet klasifikohen si detyrime afatshkurtra përveç nëse Kompania ka të drejtë të patjetërsueshme për të shtyrë marrëveshjen e detyrimit për së paku 12 muaj pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar.

Detyrimet tjera

Sigurimi dhe të pagueshmet e tjera njihen fillimisht në vlerë të drejtë dhe pastaj në kosto të amortizuar duke aplikuar normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.23 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të shkuar, është e mundur që një pakësim i burimeve që mbartin përfitime ekonomike do të kryen për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për vlerën e detyrimit. Provizionet rishikohen çdo datë bilanci dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, vlera e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kryen për të shlyer detyrimin. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative.

3.24 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet operative janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të përdorimit të shërbimit, kur kanë ndodhur.

3.25 Përfitimet e punëtorëve

Kompania sipas ligjeve në fuqi nuk ndanë rezervë dhe nuk ka asnjë obligim ligjor për pensionet e punëtorëve, përveç kontributeve të cilat i paguan tek Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.26 Kontigjencat

Kontigjencat nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Pasuritë e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare, por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

3.27 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përbëhen nga drejtorët e Kompanisë, së bashku me entitetet të cilat ata i kontrollojnë, që mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi operacionet dhe menaxhmentin e Kompanisë. Duke pasur parasysh secilën marrëdhënie të mundshme me palët e treta, vëmendja është e drejtuar më përbërjen e marrëdhënies, dhe jo thjesht në formën ligjore.

3.28 Ngjarjet pas datës raportuese

Ngjarjet pas datës raportuese që sigurojnë informata shtesë në lidhje me pozicionin e Kompanisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese), janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënimet shpjeguese kur ato janë material.

4 VLERËSIMET KRITIKE KONTABËL DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË NË VLERËSIM

Kompania kryen vlerësime, gjykime dhe supozime për vlerën e mbartur të raportuar të pasurive dhe detyrimeve përgjatë vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe supozimet janë bazuar në përvojën historike dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë rezultatet nga ngjarjet e ardhshme që janë konsideruar relevante në bazë të rrethanave. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël që kryhen në përgjithësi ndryshojnë nga rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën aktuale ashtu dhe në periudha të ardhshme.

Vlerësimi i detyrimit të kontratave të sigurimit

Vlerësimi i përgjegjësisë përfundimtare që rezulton nga dëmet e lidhura me kontratat e sigurimit është vlerësimi më kritik kontabël i Kompanisë. Kostot finale të dëmeve pezull janë vlerësuar duke përdorur disa standarde të teknikave projektuese të aktuarit për dëme.

Supozimi kryesor për këto teknika është që eksperiencat e shkuara të Kompanisë në lidhje me dëmet, mund të përdoren për projektimin e dëmeve të ardhshme dhe kështu të vlerësoj kostot finale të dëmeve. Si të tilla, këto metoda ekstrapolojnë zhvillimin e humbjeve të ndodhura dhe të paguara, kostot mesatare për dëme dhe numri i dëmeve bazuar në zhvillimet e vëzhguara të viteve të shkuara dhe koeficientëve të humbjes së pritur. Zhvillimi i dëmeve në bazë historike zakonisht është analizuar sipas viteve të aksidenteve, por mundet të analizohet edhe sipas sipërfaqes gjeografike, gjithashtu sipas linjave domethënëse të biznesit dhe llojit të demit. Përpos kësaj, gjykim kualitativ është përdorur për të vlerësuar zgjatjen në të cilën trendet e kaluara mund të mos aplikohen në të ardhmen, në mënyrë që arrijnë vlerësimet e kostos finale të dëmeve që paraqesin një gjasë daljeje nga vargu i daljeve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasiguritë e përfshira.

Humbjet nga rënia në vlerë e të arkëtueshmeve

Kompania rishikon çdo vit për rënie në vlerë të llogarive të saj të arkëtueshme që lidhen ose nuk lidhen me sigurimet. Për të përcaktuar se nëse një humbje nga rënia në vlerë duhet regjistruar në fitim ose humbje, kompania gjykon nëse ekzistojnë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një rënie në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara për një grup llogarish të arkëtueshme përpara se rënia të mund të identifikohet me një debitor individual në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një ndryshim negativ në statusin pagues të debitorit që lidhet me mos pagesën e një llogarie të arkëtueshme në grup. Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në eksperiencat të mëparshme për pasuri me karakteristika risku dhe ngjarje të rënies në vlerë të ngjashme me ato të portofolit kur përcaktohen rrjedhat e ardhshme të pasurive monetare.

5 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Struktura e menaxhimit

Objektivi primar i strukturës të menaxhimit të riskut dhe financave të shoqërisë është të mbrojë aksionarët e shoqërisë nga ngjarje që pengojnë arritjet konstante të objektivave të performancës financiare, duke përfshirë dështimin në shfrytëzimin e mundësive. Menaxhmenti e njih rëndësinë kritike e të pasurit sisteme menaxhimi të riskut eficiente dhe efektive.

Bordi i Drejtorëve aprovon politikat e menaxhimit të riskut të shoqërisë dhe mblidhet rregullisht për të aprovuar çdo kërkesë komerciale, rregulluese dhe organizative të këtyre politikave. Këto politika përcaktojnë identifikimin e riskut të shoqërisë dhe interpretimin e tij, limitojnë strukturën për të siguruar cilësinë e nevojshme dhe diversifikimin e Pasurive, drejtojnë marrjen në sigurim dhe strategjinë e risigurimit drejt qëllimeve të shoqërisë, dhe specifikojnë kërkesat raportuese.

Struktura rregulluese

Operacionet e shoqërisë janë gjithashtu subjekt i kërkesave rregulluese brenda juridiksionit ku operon. Këto rregullime jo vetëm që përshkruajnë aprovimin dhe monitorimin e aktiviteteve, por gjithashtu vendosin disa kushte shtrënguese (p.sh mjaftueshmeria e kapitalit) për të minimizuar riskun e dështimit dhe të pamjaftueshmërisë për shoqëritë e sigurimit për të shlyer detyrime të paparashikuara kur ato lindin.

Strategjia e risigurimit

Pjesa më e madhe e biznesit të sigurimeve të ceduar është vendosur në bazë të kuotës me limite mbajtjeje që variojnë nga linja e produktit dhe territori. Shumat e marra nga risiguruesit do të vlerësohen në një mënyrë konsistente me provizionet e dëmeve dhe janë në përputhje me kontratat e risigurimit. Megjithatë kompania ka marrëveshje risigurimi, nuk është e lirë nga detyrimet direkte ndaj police-mbajtësve të saj dhe kështu që një ekspozim në kredi ekziston në lidhje me sigurimet e ceduara, në masën që çdo risigurues nuk është në gjendje të plotësojë detyrimet e tij të lindura nga këto marrëveshje risigurimi. Vendosjet e shoqërisë për risigurimet është e diversifikuar në mënyrë që nuk është e varur në një risigurues të vetëm.

Margjina e rrezikut të sigurimit

Rreziku kryesor që kompania ndërmerr në kontratat e sigurimit është që dëmet aktuale dhe pagesat e përfitimit ose koha e tyre, ndryshojnë nga pritshmëria. Kjo influencohet nga frekuenca e dëmeve, madhësia e dëmeve, përfitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi i mëvonshëm i dëmeve afatgjata. Prandaj objektivi i Kompanisë është të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë të disponueshme për të mbuluar këto detyrime.

Ekspozimi ndaj riskut të mësipërm do të eliminohet nga diversifikimi ndërmjet një portofoli të madh të kontratave të sigurimit dhe zonave gjeografike. Variacioni i rreziqeve është përmirësuar gjithashtu nga një zgjedhje e kujdesshme dhe implementim të strategjive të marrjes në sigurim, si dhe përdorimi i marrëveshjeve të risigurimit.

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare
 Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020

5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Margjina e riskut të sigurimit (vazhdim)

31 Dhjetor 2020	Detyrimet Bruto (në EUR'000)	Pjesa e risiguruesit (në EUR'000)	Detyrimet Neto (në EUR'000)
Auto përgjegjësia	4,828	-	4,828
Sigurimi Kufitar	861	-	861
Fondi I kompensimit	1,055	-	1,055
Sigurimi motor Casco	96	-	96
Produktet tjera	75	-	75
Gjithsej	6,915	-	6,915

31 Dhjetor 2019	Detyrimet Bruto (në EUR'000)	Pjesa e risiguruesit (në EUR'000)	Detyrimet Neto (në EUR'000)
Auto përgjegjësia	3,738	-	3,738
Sigurimi Kufitar	811	-	811
Fondi I kompensimit	958	-	958
Sigurimi motor Casco	101	-	101
Produktet tjera	40	-	40
Gjithsej	5,648	-	5,648

Risku kreditor

Kompania nuk ka përqendrim të ndjeshëm të rrezikut të kredisë. Kompania ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë për çdo kundër palë tjetër. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël neto të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar. Dhënia e informacioneve shpjeguese për riskun e kredisë janë të përfshira brenda secilës notë të Pasurive financiare.

Pasuritë financiare	31 Dhjetor 2020 (në EUR'000)	31 Dhjetor 2019 (në EUR'000)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	602	377
Depozitat me afat	9,535	9,071
Investimet në instrumentet financiare	4,514	2,828
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	1,738	1,252
Pasuritë e tjera	2,119	2,144
EKSPOZIMET MAKSIMALE NDAJ RISKUT KREDITOR	18,508	15,672

Depozitat me Afat dhe Paraja e Gatshme dhe Ekuivalentët e saj. Të gjitha depozitat me afat dhe paratë e gatshme të mbajtura në llogarinë rrjedhëse janë në bankat e licencuara të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, ekspozimi ndaj një banke të vetme nuk duhet të kalojë 30% të depozitave me afat sipas politikave të Kompanisë dhe rregulloreve të BQK-së.

Llogaritë e arkëtueshme të Sigurimeve. Kompania menaxhon në mënyrë aktive përzierjen e produkteve të saj për të siguruar që nuk ka ndonjë përqendrim domethënës të riskut kreditor.

Investimet në instrumentet financiare. Këto investime përbëhen prej letrave me vlerë të lëshuara nga Republika e Kosovës.

Struktura e moshës së llogarive të arkëtueshme të sigurimeve deri më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare
 Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020

5 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

	31 Dhjetor 2020 (në EUR'000)	31 Dhjetor 2019 (në EUR'000)
Deri në 30 ditë	420	299
Prej 1 deri në 2 muaj	278	237
Prej 3 deri në 6 muaj	744	455
Prej 6 deri në 12 muaj	296	261
Mbi 1 vit	703	703
Minus: provizioni i zhvlerësimit	(703)	(703)
LLOGARITË E ARKËTUESHME TË SIGURIMEVE, NETO	1,738	1,252

Pasuritë financiare	31 Dhjetor 2020 (në EUR'000)	31 Dhjetor 2019 (në EUR'000)
As të vonuara e as të zhvlerësuara	299	299
